

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E HËNË 8 NËNTOR 2021

Dy ministra, me të cilët kisha punë, nuk qenkan, por besoj se ua përcjell zonja Spiropali.

Të nderuar qytetarë të Tropojës,

Të nderuar kolegë,

Jam sot përpara jush që të ngre shqetësimin e ligjshëm të banorëve të Tropojës, si përfaqësues i tyre këtu në parlament, për dy problematika shumë të mprehta, të cilat kanë të bëjnë direkt me jetën dhe shëndetin e këtyre banorëve. Marrë shkas nga show i radhës i Kryeministrit dje për pastrimin, trajtimin e plehrave dhe mbetjeve nga ana e bashkive. Shpresoj që shqetësimi i tyre të dëgjohet nga Kryeministri dhe nga institucionet e tjera përgjegjëse për të bërë të mundur financimin e këtyre projekteve dhe zgjidhjen e këtyre dy problematikave, të cilat ndikojnë direkt në jetën e banorëve të Tropojës.

Tropoja prej kohësh është kthyer në një nga destinacionet turistike për qytetarët nga e gjithë Shqipëria dhe për turistët nga të katra anët e botës dhe jo pa arsye. Natyra dhe cilësia e jetës falë kësaj natyre janë burimi kryesor i dyndjes turistike në Tropojë, por ka rreth 2 vjet që këto dy dhurata të Zotit janë goditur rëndë, duke e kthyer këtë mrekulli natyrore në një zonë të ndotur dhe të rrezikshme për shëndetin e banorëve dhe të turistëve. Kam pasur shumë ankesa nga banorët e Tropojës për këto probleme. A e dini pse? Sepse pushteti i papërgjegjshëm lokal po e shkatërron këtë natyrë, duke djegur mbetjet urbane. Kjo ka sjellë një katastrofë natyrore. Reja e tymit të plehrave është bërë pjesë e pandarë e Tropojës, duke e shndërruar qytetin e Bajram Currit dhe zonat përreth, duke përfshirë këtu zonat turistike, në një zonë të kuqe për sa i përket nivelit të ndotjes. Banorët thonë se jeta është bërë e vështirë, pasi tymi ndotës është kthyer në rrezik për shëndetin e qytetarëve. Situata është bërë e padurueshme dy muajt e fundit, sepse bashkia e pavotuar e "Rilindjes" me drejtuesit e paligjshëm, në vend që t'u japin zgjidhje banorëve për mbetjet, kanë zgjedhur katastrofën: djegin vendgrumbullimin e mbetjeve pa menduar aspak për ndotjen e natyrës së mrekullueshme të Tropojës dhe as për shëndetin e tropojanëve. Është e trishtueshme të shohësh sesi kjo perlë e natyrës të shndërrohet në një burim sëmundjesh dhe ndotjesh që do të jenë të parikuperueshme për vite e vite. Kjo situatë e rëndë do të dëmtojë shumë faunën dhe mjedisin e kësaj zone, ndërsa turizmi do të marrë një goditje të paimagjinueshme.

Ndaj, sot nga kjo foltore dua t'i them kësaj qeverie që t'i kthejë sytë nga Tropoja. Të merren masa urgjente për trajtimin e mbetjeve, duke ndalur në mënyrë urgjente katastrofën mjedisore që po ndodh. Është koha t'i japim fund tymit të korrupsionit dhe papërgjegjshmërisë së pushtetit të vjedhur në Tropojë. Tropoja nuk mund të mbetet peng i një pushteti që nuk mendon për shëndetin e tyre, por vetëm për aferat e korrupsionit të radhës. Sikur të mos mjaftonte kjo situatë, një tjetër katastrofë shëndetësore rrezikon çdo ditë shëndetin e tropojanëve. E gjithë Bashkia e Tropojës nuk ka një thertore funksionale. Në fakt, është një ndërtesë që quhet thertore, por është një vend ku vetëm mund të xhirohen filma horror. Po, po, horror! Ndërtesa është jashtë çdo standardi, pasi rrezikon jetën e qytetarëve. Është e tmerrshme situata me higjienën në këtë vend që në letra quhet thertore, por e tillë nuk mund të jetë. Imagjini një vend me baltë, pa asnjë standard, më keq se një stallë e kooperativave të dikurshme, ku pritet mishi që më pas u ofrohet qytetarëve në dyqane. Fermerët janë të detyruar t'i therin aty bagëtitë, pasi në të kundërt penalizohen me gjoba të majme, sepse nuk u lejohet të zgjedhin rrugë alternative. Imagjini se sa në rrezik është shëndeti i tropojanëve! Nuk

mund të vazhdohet kështu. Ku janë institucionet e shëndetit? Ku është ministrja që do të hapë akademi për barinj, ndërkohë s'ka asnjë kusht për prerjen, trajtimin, shitjen e mishit dhe të nënprodukteve të tij? Normalisht, nuk e kanë fare në rend të parë jetën e qytetarëve. Ministrja e Bujqësisë nuk e sheh këtë horror, sepse ajo s'ka asnjë lidhje me këta qytetarë. Kjo qeveri nuk mendon për qytetarët, sepse e ka mendjen tek afera e korrupsionit të radhës. Tropoja dhe tropojanët nuk e meritojnë këtë trajtim kafshëror. Komplet e kundërta ndodh në anën tjetër të kufirit, në komunën e Gjakovës, as njëzet minuta larg nga Tropoja. Kosova një shtet i ri, por situata në këta dy parametra ndryshon si nata me ditën me Tropojën. Tropoja dhe tropojanët nuk e meritojnë këtë qeveri e as këtë pushtet lokal të vjedhur. Ata meritojnë dhe duhet të kenë një pushtet që kujdeset për ta, jo një pushtet që u vret natyrën dhe u rrezikon shëndetin e tyre. Ndaj, sot nga kjo sallë, dua ta ngre zërin në emër të atyre banorëve, punëtorë e të ndershëm: boll më! Tropoja nuk mund të jetë viktimë e urrejtjes politike të pushtetit të vjedhur. Prandaj, kthejeni vëmendjen nga Tropoja, zoti Kryeministër! Mbështetini fuqishëm me financime këto dy projekte, sepse bashkia nuk ka fonde për realizimin e tyre, pasi po rrezikohet seriozisht shëndeti i qytetarëve! Faleminderit!